



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 4 prot.

Kamëz, më 24. 1. 2025

V E N D I M

Nr. 4 .Datë 24 / 1 2025

MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË PËR VITIN 2025”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.01.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.02 Datë 20.01.2025, në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.88 datë 15.11.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; VKB nr 103 dt.18.12.2023 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2024, 2025, 2026”; Shkresës me nr. Prot. 11049 dt. 27.12.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit të Komisionit të Strehimit me nr.574 Prot datë 16.01.2025; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencion të qirasë për 230 individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektet financiare në vlerën 44,395,720 lekë që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 50% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë një vjeçare duke filluar nga data 01.01.2025 deri në datën 31.12.2025
4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit.
5. Ky vendim, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

